



Transparenca e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë kohës së pandemisë kovid-19

ANALIZË

PANDEMIA E THELLOI DISTANCËN NË MES KUVENDIT DHE OPINIONIT

Shtator 2021

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

3HM
Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

Autorët:

Aleksandra Micoska Mitevska
Mefail Ismaili

Redaktor:

Dragan Sekulovski

Përkthimi:

Deniz Sulejman

Kopertina dhe Faqesja:

SHGM

Fotografia:

www.sobranie.mk

Botuesi:

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

Ky publikim është prodhuar në kuadër të programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perendimor dhe Turqinë" dhe veprimi i tij "HF37 – Liria e Shprehjes dhe Liria e Medias në Maqedoninë e Veriut (JUFREX)".

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon "©Këshilli i Evropës, viti i botimit".

Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Ky publikim është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyrojnë pikëpamjet zyrtare të cilës do palë.

PËRMBAJTJA

Hyrja	3
1. Konstituimi i kuvendit pa prezencën e mediave në sallë	5
2. Seancat e komisioneve të mbyllura tërësisht për opinionin	6
3. Termi "prezentë" pamundësoi online kyçje të deputetëve	8
4. Pandemia e kërcënoi opinionin në punën e Kuvendit	9
5. Mungesa e disponueshmërisë e një pjese të deputetëve	11
6. Brifingjet e kryetarit të kuvendit	12
7. Dispozita tjera nga Rregullorja që kanë të bëjnë me punën e hapur në shtëpinë ligjvënëse (nga neni 228 deri te neni 234)	13
8. Biseda me gazetarë dhe deputetë për shkëmbimin e përvojave/ Opinioni nën thjerrëzën e gazetarëve/ Mendimet e deputetëve	14
9. Bisedë me kryetarin e kuvendit Talat Xhaferi. Paralajmëron disa projekte të reja për transparencë më të madhe	30
Konkluzione	32
Rekomandime	33
Burimet e shfrytëzuara	34

HYRJE

Analiza për transparencën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën e Kovid pandemisë, është bërë në bazë të anketës me gazetarë të mediave të ndryshme nacionale dhe online medime, të cilët e ndjekin punën e Kuvendit më tepër vite ose me dekada dhe vazhdojnë të jenë aktivë. Është bërë anketë me koordinatorët e të gjitha grupeve parlamentare dhe me deputetët të cilët nuk janë pjesë e ndonjërës prej grupeve parlamentare, por edhe me Kryetarin e Kuvendit, Talat Xhaferi. Gjithashtu, janë konsultuar edhe Kushtetuta e RMV-së, Rregullorja për punë e Kuvendit dhe Kodeksi Etik i Kuvendit të RMV-së.

Transparenca e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, vazhdon të jetë e pjesshme edhe në përbërjen e saj të 10. Komunikimi i deputetëve me mediat u bë edhe më i rëndë gjatë pandemisë me kovid-19.

Protokollet e Komisionit për sëmundje infektive në periudhë prej më tepër se një vit i kanë shkyçur pothuajse tërësisht gazetarët nga puna në shtëpinë ligjvënëse dhe ata nuk kanë mundur të jenë prezentë fizikisht në seancat e komisioneve ose në seancat plenare. Për këtë shkak, gazetarët kanë më tepër vështirësi të jenë në kontakt me deputetët dhe me përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Gazetarët kishin më tepër probleme të sigurojnë informacionet e nevojshme nga seancat e komisioneve, sepse drejtpërdrejtë shkojnë vetëm seanca plenare dhe seanca e Komisionit për financim dhe buxhet edhe atë vetëm kur ka diskutim për buxhetin. Përpos kësaj, asnjë nga seancat e komisionit nuk është transmetuar drejtpërdrejtë në kanalën e kuvendit, e as në rrjetet sociale. Në këtë mënyrë, gazetarët nuk ishin të informuar për atë se çfarë ishte duke ndodhur në komisionet.

Ata mund të informoheshin vetëm nëpërmjet kontakteve personale me deputetët, anëtarë të atyre komisioneve, por brifingu me ta nuk është informacion i plotë, sepse deputetët brifojnë sipas bindjeve dhe interesave të tyre politike. Ndërsa deputetët dhe koordinatorët e grupeve parlamentare shpesh dinë edhe të mos u përgjigjen thirrjeve të gazetarëve. Posaçërisht kur nuk ju konvenon tema, ata tentojnë t'i shmangin mediumet, duke gjetur arsye të ndryshme.

Kishte më tepër kërkesa nga gazetarët që seancat e komisioneve të shkojnë drejtpërdrejtë në Youtube, Facebook ose rrjetet tjera sociale, por kjo nuk u zbatua me arsyetimet se nuk

është parashikuar në buxhet të investohet në pajisje dhe se këtë nuk e lejon Rregullorja për punë e Kuvendit.

Por, përpos që gazetarët nuk kanë qenë në mundësi t'i ndjekin seancat e komisioneve, qytetarët kishin edhe më pak mundësi të informohen për atë se çfarë punojnë të përzgjedhurit e tyre në Kuvend. Rrethanat e krijuara si pasojë e pandemisë i nxorën edhe më shumë në sipërfaqe problemet në Kuvend me transparencën dhe llogaridhënien. Për këtë shkak është e nevojshme sa më shpejtë të ndërmerren aktivitetet me të cilat do të detektohen probleme të caktuara, por edhe të gjendet mënyra e vërtetë se si Kuvendi të jetë e hapur plotësisht për opinionin.

Nga ana tjetër opinionin më i gjerë sikurse nuk është duke i ndier në atë masë të madhe kufizimet të cilat i ka imponuar pandemia. Anketa në terren e Programit për përkrahje parlamentare për perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit, e zbatuar nga 17 shkurt deri më 10 mars këtë vit, tregoi se qytetarët janë të ndarë në njohurinë e punës/çfarë kanë punuar në parlament në periudhë prej gushtit 2020 e deri në janar të vitit 2021.

Gjithsej 51 për qind e të anketuarve janë përgjigjur se pjesërisht ose tërësisht janë të njohur me aktivitetet në shtëpinë ligjvënëse në këtë periudhë, ndërsa 48 për qind kanë thënë se pak, ose fare nuk janë të njohur me performancat e deputetëve. Gjithashtu 73 për qind nga të anketuarit vlerësojnë se Kuvendi luan rol të rëndësishëm në jetën politike në vend, ndërsa kjo është për gjashtë për qind më shumë se viti i kaluar, që deri diku është e kuptueshme nëse dihet se përbërja e kaluar e kuvendit, për shkak shpërbërjes para fillimit të pandemisë nuk ka qenë në funksion më tepër se pesë muaj.

KONSTITUIMI I KUVENDIT PA PREZENCË TË MEDIAVE NË SALLËN

Më 3 gusht, viti 2020, filloi seanca konstitutive e përbërjes së dhjetë parlamentare, që u zgjodh më 15 korrik, gjegjësisht në muajin e katërt të shpalljes së pandemisë në nivel global. Përbërja e kaluar ishte shpërbërë më 26 shkurt të vitit 2020, por pandemia i prishi planet për mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare më 12 prill.

Pas më shumë se pesë muaj pauzë, nga 26 shkurt e deri më 3 gusht, përbërja e 10 parlamentare e mbajti seancën e parë jashtë sallës plenare, gjegjësisht jashtë sallës ku në vazhdimësi është mbledhur Kuvendi i Maqedonisë në këto tre dekada të pavarësisë. Në vend të saj, deputetët u shpërngulën në “sallën e kupolave”, ku u mbajtën seancat plenare deri më 8 qershor të këtij viti, pra gati se një vit.

Kryetari i Kuvendit, Talat Xahferi si dhe përfaqësues të Komisionit për Sëmundje Infektive morrën vendim se është më e sigurt nga aspekti i sigurisë, nëse kuvendi mblidhet në “sallën e kupolave”, për shkak gjerësisë së saj dhe mundësisë të mbahet më lehtë distanca. Por, kjo nënkuptonte edhe shkyçjen e opinionit nga seancat plenare, kështu që gazetarët u pamundësuan që të ndjekin diskutimet direkt nga salla plenare.

Në këtë rast, menaxhmenti i Kuvendit dhe përfaqësues të grupeve parlamentare, por edhe të Komisionit për Sëmundje Infektive nuk e morën parasysh rolin e gazetarëve në Kuvend por vetëm sigurinë e deputetëve dhe të punësuarve në shtëpinë ligjvënëse.

Kufizimi i tillë i prezencës së gazetarëve, por edhe mungesa e vullnetit që të gjendet mënyrë se si gazetarët të kenë më tepër qasje deri tek seancat e Kuvendit dhe Komisionit, krijoi boshllëk në komunikimin mes gazetarëve dhe deputetëve, mundësisë minimale për informim të qytetarëve për atë se çfarë po ndodh në Kuvend, si dhe për transparencë minimale të Kuvendit.



Sipas nenit 70 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, seancat e Kuvendit kanë qenë publike. Kuvendi mund të vendos të punojë pa prezencën e opinionit me shumicë prej dy të tretave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Por, nën presionin e kushteve shëndetësore, këto dispozita, në një farë mënyre ishin suspenduar, pa dallim atë se në "Sallën e kupolave" nuk ka kushte për mbulim mediatik të seancave, për dallim nga salla e vjetër, ku galeria është e "rezervuar" për gazetarët.

Kësaj radhe, gazetarët ishin të detyruar t'i ndjekin seancat e Kuvendit live në kanalin e Kuvendit në TVM, që, në më shumë aspekte nuk paraqet zëvendësim i mirë për ndjekje nga vendi i ngjarjes. Kështu, për shembull, votimi i parë në kabinë të posaçme të një deputeti i dyshuar me covid-19, që ndodhi gjatë kohës së zgjedhjes së Qeverisë më 30 gusht 2020, ka mundur të kalojë pa u vërejtur nga mediat, nëse për të, Kryetari i kuvendit nuk i njoftonte deputetët.

Si pengesë në lidhje me hapjen e shtëpisë ligjvënëse u imponua edhe principi i ndryshuar i votimit në sallën e re, me kartonë me ngjyrë, ndërsa sistemi elektronik për votim mbeti në sallën e vjetër. Me këtë edhe gazetarëve u pamundësua qasja në rezultatin e votimit dhe për vendimin për çdo deputetë veçmas.

2

SEANCAT E KOMISIONEVE JANË TËRËSISHT TË MBYLLURA PËR OPINIONIN

Megjithatë, si problem i posaçëm u tregua pamundësia në mbulimin mediatik të seancave të komisioneve, të cilat, zakonisht nuk shkojnë drejtpërdrejtë, ndërsa transmetohen te kanali i Kuvendit, disa orë pas mbarimit të seancës, pa e ditur saktësisht dhe kur do të jetë transmetimi. Shpesh herë seancat emitohen pasdite, kur pjesa më e madhe e televizioneve kanë mbaruar me përgatitjen dhe transmetimin e lajmeve qendrore, ndërsa gazetaret veçmë janë lëshuar në shtypje, kështu që ndodhitë në komisionet, në valën e pandemisë, kryesisht kanë mbetur të pambuluara nga mediat.

Për shkak se nuk kishte kushte teknike që të sigurohen transmetime të drejtpërdrejta nga seancat, me përjashtim të sallës së vetme "Boris Trajkovski", gazetarët u detyruan që për ndodhitë në grupet punuese të Kuvendit të informohen nga deputetët.

Duke e pasur parasysh subjektivitetin e deputetëve, gjegjësisht përkatësinë e tyre partiake, si dhe rrethin e kufizuar për komunikim, duke e ditur se jo të gjithë deputetët që janë pjesë e ndonjë komisioni të caktuar kanë disponim për kontakt me mediumet, gazetarët jo rrallë janë të detyruar që të gjinden në mënyrën e tyre që të sigurojnë informacion më objektiv.

Për shkak seancave të mbyllura të komisionit, për shembull do të mbeteshe pa vërejtur sjellja e ligjit për objektet e ndërtuara pa leje, për të cilin opinioni u njoftua pas u votua në seancë plenare, në të cilën, siç u mësua më vonë, i ka paraprirë debat i qetë për propozim-ligjin (i propozuar nga Qeveria, ndërsa i përgatitur në Ministrinë për Transport dhe Lidhje) në Komisionin për transport dhe lidhje, kryetar i të cilit është Vllado Misajllovski nga VMRO-DPMNE. Më pas u mësua se arsyeja për sjelljen e qetë të ligjit, në situatë kur shumica parlamentare mezi arrinte kuorum, mes tjerash edhe për bllokimet e opozitës, është marrëveshja politike mes LSDM-së, VMRO-DPMNE-së dhe BDI-së, për ligjin i cili mundëson legalizimin e objekteve pa leje, i cili, pasi për të mësuan mediat, u tërheq nga procedura nën presionin e opinionit dhe me “veton” e kryetarit të shtetit.

Gjithashtu, u vërejt mungesë e informacioneve edhe për diskutimet për Ligjin për shtetësi, i propozuar nga opozita në bllokun shqiptar, i cili ligj u kundërshtua nga partia politike E Majta, ndërsa kishte shumë kritika edhe nga partia më e madhe në opozitë VMRO-DPMNE.

Në lidhje me këtë ligj kishte disa diskutime në Kuvend, seanca të komisioneve të pafilluara, dorëzimi i mijëra amendamenteve për bllokimin e ligjit, por gazetarët nuk kishin qasje në seancat e komisionit amë dhe nuk kanë pasur mundësi ta transmetojnë fotografinë e vërtetë për diskutimet dhe mospajtimet mes deputetëve.

E njëjta situatë ishte edhe për ligjin për letërnjoftime, e dorëzuar nga Besa, me të cilin parashikohet “grafa etnike në dokumentet personale” si dhe për ligje tjera për të cilat kishte interesim të madh të opinionit.

Në një farë mënyrë u krijua hapësira deputetët të ndjehen më të lirë dhe të kenë mundësi të shprehen me fjalorë më të lirë dhe kritika ndaj kundërshtarëve politik, sikur të jenë në “ambient të mbyllur privat” sepse në sallën nuk ka gazetarë dhe kamera televizive.

Për shkak se gazetarët nuk kishin qasje te seancat e komisionit, mund të thuhet se raporti për punën e komisioneve, posaçërisht kur në rend të ditës ishin ligjet me interes më

të madh për opinionin ishte me shumë mungesa dhe jo e plotë. Për diskutimet në këto komisione gazetarët mund të informonin dhe të transmetojnë informacione vetëm kur deputetët të cilët janë anëtarë të komisionit do të pranonin të jepnin deklaratat. Por, edhe në raste të tilla gazetarët shpesh herë nuk kishin mundësi të jenë objektiv deri në fund. Nëse kishte diskutim për ndonjë ligj, dhe nëse për deklaratë paraqiteshin deputetët nga opozita, shpesh ndodhte që deputetët e pushtetit të jenë të pakapshëm, të refuzojnë t'i tregojnë qëndrimet e tyre ose thjesht të përgjigjen në telefon se janë të zënë për momentin. Dhe, e kundërta. Rrethanat e tilla, si dhe sjellja e tillë, i pengonte gazetarët të jenë tërësisht objektiv dhe të mund në mënyrë më profesionale të bëjnë punën e tyre.

Një grup i gazetarëve, në disa raste, kërkuan nga kryesia e Kuvendit që të mundësoj edhe seancat e kuvendit të shkojnë drejtpërdrejtë në faqet zyrtare të Kuvendit në rrjetet sociale, shembull Youtube, Facebook... por nga Kuvendi përgjigja ishte çdoherë e njëjtë-se nuk kanë kushte teknike, se nuk kanë të parashikuar buxhet, por edhe se janë në kontakt me fondacione të huaja dhe organizata që të ndihmojnë në lidhje me kërkesat e gazetarëve.

3 TERMI “PREZENTË” PAMUNDËSOI KYÇJE ONLINE TË DEPUTETËVE NË SEANCAT

Dhe, përderisa gazetarëve me arsyetimin se nuk ka kushte teknike për striming, u ishte pamundësuar edhe ndjekja online e ngjarjeve në kuvend, shumica parlamentare ishte e gatshme të parashikojë edhe online pjesëmarrje në seancat e kuvendit për deputetët që janë në izolim, që të tejkalohen problemet me kuorumin, të cilat ishin pjesë e pashmangshme në kulmin e pandemisë, kur edhe një numër i mirë i deputetëve ishin të detyruar të shkojnë në karantinë.

Sipas rezultateve nga anketa në teren për perceptimin e qytetarëve për punën e Kuvendit, në kuadër të Programit për përkrahje parlamentare, dy e treta e qytetarëve përkrahin online punë të parlamentit, ndërsa për një pjesë të vogël e të anketuarve, nuk është e nevojshme lloji i tillë i punës.



Megjithatë, kuvendi i Maqedonisë mbeti një nga të rrallit në Evropë ku nuk u sigurua alternativë për pjesëmarrje në seancat për shkak kundërshtimit të opozitës, e cila u thirr në nenin 69 të Kushtetutës, sipas të cilit, Kuvendi mund të vendos nëse në seancë janë prezentë shumica nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Më saktësisht termin "prezent" opozita e ka interpretuar si imperativ për prezencë fizike të deputetit në seancë plenare, kështu që, në fund, spikeri Talat Xhaferi i tërhoqi nga procedura propozim-ndryshimet në Rregulloren që vet i propozoi.

Mungesa e alternativave për mbajtjen e seancave të kuvendit në kushte të kovid-19, në mënyrë shtesë i hollojë ngjarjet në shtëpinë ligjvënëse, që kontribuoi edhe për reduktim të mëtutjeshëm të kontakteve direkte mes deputetëve dhe medimeve.

4

PANDEMIA E KËRCËNOI OPINIONIN NË PUNËN E KUVENDIT

Edhe pse, përpos Kushtetutës edhe Rregullorja e Kuvendit, parasheh opinionin të shih se çfarë punohet në Kuvend, ky princip i rregullores nën fuqi të rrethanave ishte kërcënuar gjatë kulmit të pandemisë, me atë që gazetarëve u pamundësua që të ndjekin drejtpërdrejtë ngjarjet në Kuvend. Përveç kësaj, sjellja e një numri të madh të deputetëve ose të shefave të grupeve parlamentare, të cilët, në më tepër raste, nuk treguan vullnet që të kumtojnë me kohë qëndrimet, e kërcënoi informimin objektiv, ndërsa ndikoi edhe në profesionalizmin e gazetarëve të kuvendit, të cilët çdoherë janë munduar që në përmbajtjet / tekstet t'i kenë qëndrimet e të gjitha palëve.



Sipas Rregullores, Kuvendi siguron informim të opinionit për punën e Kuvendit dhe për trupat punuese, si dhe për delegacionet e vazhdueshme në organizatat ndërkombëtare. Neni 266 thotë se qytetarët mund t'i ndjekin seancat e Kuvendit dhe të trupave punuese nga galeritë, në përputhje me rregullat për rendin e brendshëm. Përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik, në përputhje me rregullat për rendin e brendshëm të Kuvendit, siç është e paraparë, mund të marrin pjesë në seancat e kuvendit dhe të trupave punuese për shkak njoftimit të opinionit për punën e tyre.

Asgjë nga kjo nuk ishte mundësuar gjatë pandemisë, kur në Kuvend nuk kishte aktivitetet si zakonisht, gjegjësisht shpesh u anulonin seancat e kuvendit dhe të grupeve punuese, në shumicën e rasteve për shkak pamundësisë që të sigurohet kuorum, në situata kur deputetët e shumicës ishin në izolim.

Përpos dispozitave të Rregullores edhe në Kodeksin e kuvendit opinionin në punën është parashikuar si një nga parimet themelore etike, përsëri objektivitetit, përgjegjësisë dhe respektimit të ndërsjellë dhe respektimit të integritetit të tjerëve.



Sipas nenit 5 nga Kodeksi etik, deputetët funksionin e kryen me vetëdije dhe me përgjegjësi dhe gjatë kohës së kryerjes së funksionit është i hapur ndaj mediave për të gjitha pyetjet, përpos nëse pyetjet për interes të Kuvendit janë të karakterit të besueshëm ose bëhet fjalë për informacione lidhur me jetën e tij private ose për jetën private të personave tjerë.



MUNGESA E DISPONUESHMËRISË E NJË PJESE TË DEPUTETËVE

Edhe kjo garniturë e Kuvendit nuk mbeti immune ndaj mosdisponueshmërisë së një pjesë të deputetëve. Më saktësisht, në këtë përbërje, e cila filloi me punë nën protokolle të posaçme, kjo posaçërisht erdhi në shprehje, për shkak se raportuesit e kuvendit, praktikisht, nuk kishin mundësi të njihen me të gjithë deputetët. Posaçërisht me ata për të cilët ky është mandati i parë i tyre, ndërsa të tillë ka më shumë në bllokun e opozitës për shkak të ndryshimit në kreun e VMRO-DPMNE-së, që ndodhi në mes dy cikleve zgjedhore, ndërsa në LSDM dhe BDI për shkak tërheqjes së një pjesë të deputetëve dhe largimit në pushtetin ekzekutiv.



Anëtarëve të kuvendit të cilëve kjo është mandati i parë nuk kanë shumë përvojë në kontaktet me mediumet, e as, që çdo deputetët ka "autorizim" nga partia e tij që të jep deklarata, edhe pse sipas nenit 62 nga Kushtetuta, deputeti i përfaqëson qytetarët në Kuvend dhe vendos në bazë të bindjes së tij.

Kështu në kushte të komunikimit të kufizuar mes Kuvendit dhe opinionit, kontaktet mes deputetëve dhe gazetarëve në pjesën më të madhe u shndërruan në konferenca për shtyp të përfaqësuesve të grupeve parlamentare për tema që i favorizojnë qendrat partiake, në të cilat jo rrallë përfaqësuesve të mediave ju kufizohet mundësia të parashtrojnë pyetje nga interesi i tyre, për tema tjera.

Gjithashtu, nuk u ndërmor asnjë iniciativë nga koordinаторët e grupeve parlamentare, që të kenë brifingje ose takime me gazetarët, për të informuar për qëndrimet e grupit parlamentar për ligje të caktuara kritike, por edhe për gazetarët të njihen me deputetët me të cilët aspak nuk kanë pasur mundësi të shihen, pavarësisht nëse arsyeja për të është pa-interesimi i disa deputetëve të caktuar të jenë më tepër prezentë në opinion por se për shkak kushteve të kufizuara për lëvizje në Kuvend.

Edhe përkundër ndryshimit drastik të kushteve për punë të kuvendit, kryetari i kuvendit, Talat Xhaferi, gjatë gjithë kohës, nuk hoqi dorë nga "tradita" që e kishte vendosur në mandatin e kaluar - për brifingje të rregullta me gazetarët një herë në muaj. Dallimi i vetëm në këtë mandat, është që brifingjet, në pjesën më të madhe, u mbajtën në sallën e kuvendit më të gjerë, e gjithë kjo për shkak protokolleve shëndetësore të cilat parashikojnë mbajtjen e distancës, pajisjeve mbrojtëse dhe dezinfektimit.

Me përjashtime të rralla, brifingjet e Xhaferit janë mbajtur të enjten e fundit të muajit, para seancës për pyetje të deputetëve dhe paraqisnin mundësi për gazetarët që të sigurojnë më tepër informacione për aktivitetin e kuvendit gjatë muajit që kalon dhe për planet për muajin që pason.

Megjithatë, duhet të merret parasysh se kryetari i kuvendit është "i pari në mesin e të barabartëve" dhe se në çdo rast, është përfaqësues i njërës nga partitë në pushtet, kështu që komunikimi i tij i rregullt me mediumet nuk është i mjaftueshëm që të sigurohen pozicionet e të gjitha grupeve parlamentare të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse brifingjet e Talat Xhaferit, kryesisht janë me qëllim që gazetarët të jenë në rrjedha me punën e Kuvendit dhe për planet e Kryetarit të Kuvendit për punën e shtëpisë ligjvënës në muajt e ardhshëm, shpesh ndodhte që këto plane të mos zbatohen ose pjesërisht të zbatohen, për shkak të mospajtueshmërisë nga ana e koordinatorëve të grupeve parlamentare për gjëra konkrete.

Por, edhe për mospajtueshmëritë e tilla, gazetarët nuk ishin tërësisht dhe objektivisht të informuar, ngase shefat e grupeve parlamentare, posaçërisht në përbërjet e fundit të kuvendit, nuk vendosën praktikën të paktën për brifingje periodike, nëse jo edhe të rregullta me gazetarët një herë në javë ose në muaj. Për këtë shkak, më shpesh për mospajtueshmëritë e pushtetit dhe opozitës, ose për mospajtueshmëritë e kryetarit të Kuvendit me grup parlamentar të caktuar, gazetarët do të merrnin informacion vetëm në ditën kur deputetët do të vendosnin se "kacafytja" duhet të merr jehonë në opinion dhe kur do të vendosnin të dilnin në pres-konferencë.

DISPOZITA TJERA NGA RREGULLORJA QË KANË TË BËJNË ME PUNËN E HAPUR NË SHTËPINË LIGJVËNËSE

- 
Neni 228: Përfaqësuesve të mjeteve të informimit publikë u vihen në dispozicion aktet që i shqyrton dhe i miraton Kuvendi, materialet informative dhe dokumentuese për çështjet që shqyrtohen në Kuvend dhe në trupat punues, raportet e punës së trupave punues dhe procesverbalet e mbledhjeve, përveç nëse Kuvendi, përkatësisht trupi punues ka vendosur që çështje e caktuar të shqyrtohet pa pjesëmarrjen e përfaqësuesve të mjeteve të informimit publikë.
- 
Neni 229: Mënyra e realizimit të të drejtave, detyrave dhe përgjegjësi të përfaqësuesve të mjeteve të informimit publikë në Kuvend, rregullohet me akt që e miraton Kryetari i Kuvendit.
- 
Neni 230: Kuvendi dhe trupat punues kompetentë mund të vendosin që propozim-ligji ose propozim-akti tjetër i përgjithshëm që shqyrtohet në Kuvend, dhe i cili është me interes të veçantë për publikun, të shpallet nëpërmjet shtypit ose në botim të veçantë.
- 
Neni 231: Kuvendi dhe trupat punues mund të vendosin, me qëllim të njoftimit të publikut për punimet e Kuvendit, të lëshohet komunikatë për mjetet e informimit publik, pas seancës së Kuvendit ose mbledhjes të trupit punues që është mbajtur pa praninë e publikut, përkatësisht pa praninë e përfaqësuesve të mjeteve të informimit publik, si dhe në raste të tjera kur për atë do të vendosë Kuvendi ose trupi punues.
- 
Neni 232: Konferenca për shtyp në lidhje me punën e Kuvendit, mbahet kur për këtë vendos Kryetari i Kuvendit, grupi i deputetëve, trupi punues ose shefi i delegacionit i cili ka qëndruar jashtë shtetit, të cilët e caktojnë edhe përfaqësuesin që do ta mbajë konferencën për shtyp.
- 
Neni 233: Kuvendi ka ueb faqen në të cilën futen të dhënat e përgjithshme për Kuvendin, trupat punues, Kryetarin e Kuvendit, deputetët, grupet parlamentare, delegacionet

e Kuvendit, ligjet e miratuara, seancat dhe aktivitetet e tjera të Kuvendit, për Shërbimin e Kuvendit dhe të dhëna të tjera në lidhje me organizimin dhe punën e Kuvendit.



Neni 234: Me qëllim të informimit për punën e vet, Kuvendi boton buletin dhe publikime të tjera. Buletini u dërgohet të gjithë deputetëve të Kuvendit, dhe publikohet në uebfaqen e Kuvendit

8

BISEDA ME GAZETARË DHE DEPUTETËT PËR SHKËMBIMIN E PËRVOJAVE

Për shkak se transparenca e Kuvendit ishte e pjesshme dhe është e qartë nevoja për veprim për përmirësimin e kushteve për mjetet e informimit që të kenë më tepër mundësi që të raportojnë në mënyrë transparente dhe objektive, biseduam edhe me Kryetarin e Kuvendit, Talat Xhaferi, me koordinatorët e të gjitha grupeve parlamentare, me deputetët e partive më të vogla të cilët nuk kanë grup parlamentar por edhe me gazetarë nga media të ndryshme, të cilët raportojnë nga Kuvendi dhe kanë përvojë shumë vjeçare.

GAZETARËT, PROBLEMET E TYRE DHE SFIDAT PËR INFORMIM PROFESIONAL TË OPINIONIT

Në bisedë me gazetarët, një pjesë e të cilëve për punën e Kuvendit raportojnë edhe me dekada, ata i tregojnë problemet e tyre jo të përditshme me të cilat ballafaqohen për të arritur deri tek informacioni dhe që të mund të informojnë në mënyrë objektive dhe profesionale. Kemi biseduar për gjashtë pyetje konkrete edhe atë:

1. Si e vlerësoni funksionimin e kuvendit në kulmin e pandemisë me kovid-19, nga aspekti i transparencës dhe të qenit të hapur ndaj opinionit dhe medimeve?

2. Sa në përgjithësi jeni të kënaqur me transparencën dhe llogaridhënien e kësaj përbërje të kuvendit, krahasuar me ato më parë?
3. A nuk paraqet problem komunikimi dhe sigurimi i informacioneve nga deputetët, para se gjithanshme kryetarin dhe nënkryetarët e kuvendit, sekretarin gjeneral, koordinatorët e grupeve parlamentare dhe kryetarët e komisioneve?
4. Nëse në katër vitet e fundit jeni ballafaquar me presion për shkak teksti objektiv në lidhje me punën e Kuvendit ose anëtarë të parlamentit?
5. Nëse Kuvendi ka kushtet të mjaftueshme teknike që të mundësojë Gazetarëve më lehtë të kenë qasje deri tek informacionet, për ndjekjen e seancave plenare, seancat e komisioneve dhe ngjarjeve tjera. Dhe, si e vlerësoni tentimin nga ana e Kuvendit, kushtet teknike t'i përmirësojë dhe t'i harmonizojë me masat e sjellura për punë për shkak pandemisë me kovid-19.
6. Çfarë sipas mendimit tuaj, mund të ndërmerret që të mundësohet transparencë më e madhe në shtëpinë ligjvënëse dhe komunikim më i lehtë mes anëtarëve të kuvendit, administratës së kuvendit dhe gazetarëve?



Gazetarja **Julijana Lefkovska Peshevskaja** e cila punon në Televizionin **Telma** në përgjigjen e pyetjes së parë thotë se *"Kuvendi pjesërisht ka qenë transparente dhe objektive gjatë kohës së pandemisë. Mediumet nuk kanë pasur mundësi ta ndjekin punën e komisioneve". Për krahasimin e kësaj përbërje të kuvendit me përbërjet e kaluara, ajo vlerëson se "Kjo përbërje e kuvendit ka llogaridhënie dhe transparencë më të madhe". Në lidhje me mundësitë për komunikim, Lefkovska përgjigjet: "Nuk kam problem me komunikimin e personave të përmendur, janë të hapur dhe të kapshëm për bashkëpunim dhe personalisht i sigurojë informacionet e nevojshme", gjithashtu thotë se nuk ka pasur asnjë*

presion për ndonjë tekst të publikuar. Për kushtet teknike për informim të lirë dhe profesional të gazetarëve gjatë periudhës së pandemisë ajo thotë se *“Nuk ka kushte teknike të mjaftueshme, duhet të punohet në këtë plan që të mund të sigurohet që online të ndiqen të gjitha komisionet”. Dhe në pyetjen e fundit u rekomandon udhëheqësisë së kuvendit “të mundësohet kushtet teknike më të mira”.*



Gazetarja **Fatlume Dervishi** nga Televizioni **Alsat-M**, për funksionimin e Kuvendit dhe për transparencën në periudhën e pandemisë thotë se *“Kuvendi, i cili në vitet e fundit është shndërruar në institucionin më të ngarkuar, e prishi këtë përshtypje gjatë pandemisë. Ndoshta për shkak se situata nuk ishte parashikuar, deputetët nuk arritën të adaptohen plotësisht në kushtet e reja për punë dhe niveli i transparencës është zvogëluar. Në pjesën më të madhe, gazetarët por edhe opinioni, nuk kanë pasur qasje deri tek përmbytja e debatit i cili zhvillohej në seancat e grupeve punuese ose të komisioneve, ku kishte diskutime për vendime të rëndësishme. Gazetarët shumë vështirë*

vendosnin kontakte verbale me deputetët me të cilët tani më nuk mund të takoheshin fizikisht. Siç ne gazetarët kishim mungesë të informacioneve, ashtu edhe deri tek qytetarët nuk arrinin mjaftueshëm informacionet. Kur institucionet tjetra ndërmerrnin hapa tjerë të mëdha në drejtim të ndryshimit të qasjes deri te opinioni, Kuvendi u kënaqte me hapa të vogla ndoshta edhe të pamjaftueshme”.

Në pyetjen se sa është e kënaqur me transparencën dhe llogaridhënien e kësaj përbërje të kuvendit, në krahasim më të tjerat, përgjigjet, *“Dallimi do të thoja është teknik, por thelbësor. Mungesa e kontaktit direkt dhe pamundësia të takohemi me deputetët në Kuvend, përderisa ata i kryenin obligimet e përditshme, ndikon në uljen e transparencës në lidhje me mediumet dhe opinionin”.*

Për problemet me komunikimin dhe sigurimin e qëndrimeve dhe informacioneve, ajo shpjegon se *“Takimi joformal çdo muaj tek Kryetari i Kuvendit me gazetarët është përvojë e jashtëzakonshme, e cila nuk ka qenë praktikë më herët. Gjithsesi se informacionet nga takimet joformale mund të interpretohen gabimisht, të kuptohen gabimisht, mund të mos*

jenë edhe të plota. Por, politika e televizioneve, radiove, mediave digjitale është e tillë që kërkon të ketë më tepër zëra (burime, njerëz që flasin", që të jetë më profesional raportimi edhe në aspektin përmbajtjesor dhe vizual. Kështu që dua të them se ndonjëherë takime të tilla janë "humbje kohe" nëse me vete në redaksi nuk sjellim pjesë tonike atë ditë pune".

Gazetarja Fatlume Dervishi përgjigjet se në katër vitet e fundit nuk është ballafaquar me presion për shkak ndonjë teksti të publikuar në lidhje me punën e Kuvendit ose anëtarëve të kuvendit. Ndërsa për kushtet teknike me të cilat punonin gazetarët ajo thotë, "Arsyetimi për atë se përse Kuvendi nuk e transmeton në pjesën më të madhe punën e Komisioneve, të cilat nuk ishin të kapshëm për gazetarët në kohë reale të nxjerrin lajmë, ishte se kuvendi nuk i ka pajisjet teknike për atë dhe se nuk ka mundësi për vendosjen e pikës së tillë në planin për furnizime publike. Të paktën këtë na e kanë thënë publikisht. Ndërsa nëse kjo është e saktë askush nuk e heton. Janë bërë disa përpjekje dhe u siguruan kushte teknike për pjesëmarrje të gazetarëve në konferencat për media, duke respektuar rregullat e vendosura për shkak situatës me pandeminë por këtu mbaroi e gjitha".

Për hapat që duhet të ndërmerr kuvendi në përmirësimin e kushteve për gazetarët, Dervishi propozon "Kuvendi duhet t'i sigurojë të gjitha kushtet dhe pajisjet e nevojshme për transmetim online të tërë punës së seancave plenare por edhe të seancave të komisioneve. Me ose pa Kovid, ne jemi në kohë kur teknologjia është e përkryer dhe arsyetimi se për hapjen e një kanali në Youtube është e nevojshme procedurë për furnizim publik është qesharake dhe jologjike për gjeneratat e reja në gazetari. Në kohë kur informacioni është lajm vetëm në 30-60 minutat e ngjarjes, të presësh reprizë të ngjarjes pas disa orëve prej kur realisht ka ndodhur, madje edhe të mos kesh renditje se kur do të lëshoj reprizë kanali i kuvendit të asaj ngjarje është absurde. Besoni ose jo pas shumë viteve na është dashur ta ri-instalojmë "Internet Explorer" sepse është aplikacioni i vetëm në të cilën mund të hapen seancat e kuvendit të cilat shkojnë drejtpërdrejtë. Gazetarët duhet të kenë qasje në platformën "e-deptuati" poashtu si deputetët ose të paktën qasje deri tek të gjithë propozim ligjet, menjëherë sa të hyjnë në arkivin e kuvendit. Grupet parlamentare duhet të angazhojnë më tepër njerëz për kontakt me gazetarët".



Gazetarja **Mariela Trajkovska** e cila shkruan për online mediumin **Plusinfo** vlerëson se “Pandemia e koronavirusit për çdo rast e ka rënduar transparencën e kuvendit ndaj medimeve. Kjo donë të thotë se më vështirë sigurohen deklarata nga deputetët, posaçërisht me kamerë. Gazetarët që kanë punuar nga shtëpia deklarata kanë siguruar nga telefoni, që është edhe më lehtë, por, nga ana tjetër është pengesë për ta, sepse nuk kanë qenë në vendin e ngjarjes dhe nuk kanë pasur qasje të saktë se çfarë ka ndodhur në Kuvend”. Për dallimin nga përbërja e tanishme dhe e mëparshme e Kuvendit ajo përgjigjet: “Nuk shoh ndonjë dallim të rëndësishëm në lidhje me transparencën e përbërjes

aktuale të kuvendit me të kaluarat. Funksionon më tepër praktika e vendosur dhe nuk dalton në kuptimin pozitiv ose negativ”.

Për problemet me vendosjen e komunikimit dhe sigurimin e qëndrimeve nga palët në kuvend, Trajkovska përgjigjet se edhe në këtë aspekt nuk sheh ndonjë dalim të madhe krahasuar me përbërjet e kaluara. “Zakonisht koordinatorët e grupeve parlamentare përgjigjen pyetjeve pa dallim nëse bëhet fjalë për deklarata për ndonjë ndodhi gjatë ditës ose për ndonjë temë të caktuar. Kryetari i kuvendit ndonjëherë, ndoshta sipas vlerësimeve edhe vet personalisht jep qëndrim për çështje dhe tema, por kjo nuk do të thotë se çdoherë është i kapshëm. Nëse ai vendos të heshtë për ndonjë temë të caktuar, atëherë asgjë nga transparenca. E njëjtë është komunikimi edhe me nënkryetarin dhe me sekretarin gjeneral. Kryetari e mbajti praktikën që një herë në muaj të realizojë takime me gazetarët, por nuk shoh tentim nga ana e tij për transparencë më të madhe. Jep deklarata kur ai do të vlerësojë se opinioni duhet ta dëgjoj qëndrimin e Kuvendit”

Ajo poashtu përgjigjet se në katër vitet e fundit, personalisht nuk është ballafaquar me presion nga Kuvendi për tekst të publikuar. Por në lidhje me kushtet teknike vlerëson se. “Ka shumë punë për gazetarët të marrin lehtë informacione. Në kohë të pandemisë, Kuvendi mundësoi ndjekje online të seancave plenare, por diskutimi në komisione, aty ku merret fotografia e vërtet nëse një ligj do të kalojë dhe cilat janë vërejtjet mbet e mbyllur për mediumet, gjegjësisht për opinionin” Ndërsa rekomandon “Kuvendi duhet të mundësojë transmetim të drejtpërdrejtë edhe të debateve në komisionet. Transmetim të drejtpërdrejtë edhe të deklaratave të deputetëve. Për tema të rëndësishme është e nevojshme transpar-

encë më e madhe të kryetarit të Kuvendit, gjegjësisht ekipi i kryetarit të bëjë vlerësim se nëse ndonjë çështje është e interesit më të madh të opinionit në bazë ditore të caktojë pres konferencë”.



Gazetari i **TV 21**, **Besir Arifi** për funksionimin e kuvendit dhe transparencën ndaj opinionit dhe medimeve gjatë periudhës së Kovid krizës mendon se “Zyra për marrëdhënie me opinionin ishte e hapur për të dhënë informacione. Deputetët poashtu ishin të kapshëm për deklarata. Fakti që nuk kishte mundësi me kamera të jemi prezentë në seancat e komisionit dhe ajo që seancat e komisionit nuk u transmetonin drejtpërdrejt ishte një mungesë e madhe”.

Ai përgjigjet se nga kjo përbërje e Kuvendit është “Pjesërisht i kënaqur”. Për problemet me komunikimin dhe sigurimin e qëndrimeve, Arifi shton se “Në përgjithësi nuk më ka ndodhur të kem probleme. Kanë qenë të hapur për komunikim, përpos në situata kur ka pasur ndonjë temë ‘të nxehtë’ dhe ka pasur mospajtueshmëri të mëdha, ndoshta edhe në vet koalicionin. Në raste të tilla përfaqësuesit e partive shmangin të flasin hapur”.

Shpjegon se në katër vitet e fundit janë ballafaquar me presion për shkak tekstit/ kronikës së publikuar në lidhje me punën e Kuvendit dhe anëtarëve të parlamentit. Në lidhje me kushtet e mjaftueshme teknike dhe tentimin e kuvendit që t’i përmirësojë këto kishte për punë të gazetarëve, Ariif thotë “Jo, mospasja e transmetimit të drejtpërdrejt të çdo komisioni në kohë reale është në lëshim i madh. Nuk kam vërejtur tentimi që të rregullohet ose përmirësohet situata në këtë drejtim”.

Për masat që duhet të ndërmerren, Ai propozon “Përditësim më të shpejtë të ueb faqes me dokumenteve, propozim-ligje për të cilat bisedohet në Kuvend. Krijimin e kanaleve për transmetim të drejtpërdrejt të komisioneve dhe seancave plenare, të cilat do të mund edhe të kthehen prapa përderisa shkojnë drejtpërdrejt që të shikohen përsëri ato momente nga seanca që janë humbur, si dhe materialet nga seancat të mund të shkarkohet nëpërmjet internetit.”



Katerina Neshkova, gazetare e Televizionit **Sitel**, në pyetjen se si e vlerëson funksionimin e kuvendit gjatë periudhës së covid-19 përgjigjet *“nëse duhet vlerësim nga 1 deri në 5 atëherë do them 2. Plotësisht kuvend i mbyllur... caktimi i rrallë i seancave, informacionet për pikat dhe punën e kuvendit arrinin në 5 në 12. Pjesa më e madhe e aktiviteteve të Kuvendit, gjegjësisht pjesa më e madhe e komisioneve kuvendore, nuk mundeshe të shikohen drejtpërdrejt e as online”.*

Për transparencën dhe llogaridhënien e kësaj përbërje të kuvendit, krahasuar me përbërjet e mëparshme, ajo thotë se *“është më pak e kënaqur. Kabineti i kryetarit*

është shndërruar në një njeri për dhënien e informacioneve teknike, pa mundësi për qëndrim dhe përgjigje në pyetjet e parashtruara. Grupet parlamentare janë shndërruar në koordinatorët të cilët jo çdoherë janë të kapshëm për gazetarët.”

Në lidhje me komunikimin me deputetët dhe funksionarët tjerë të Kuvendit, Neshkova thotë se po, ka probleme dhe se *“Ende telefonat e tyre zyrtar nuk janë publike ndërsa mejl adresat edhe nëse i kanë nuk i kanë në funksion”.*

Ndërsa për ballafaqimin me presione eventuale për ndonjë tekst ose kronikë, ajo përgjigjet *“Po, por vetëm presion fillestar pas çka janë tërhequr”.* Për kushtet teknike momentale dhe tentimet për përmirësimin e tyre, gazetarja Katerina Neshkova thotë se *“Kishte një tentim modest nga ana e shërbimeve në muajt e parë të pandemisë, ndërsa më pas e tëra u shndërruar në përshtatje të sallës kristale si sallë për shtypin sepse kishte hapësirë më të madhe. Por, kjo sallë është pa dritare dhe pa ventilim. Kështu që, po, në vend të mbrojtjes u fitua rrezik më i madh i përhapjes së infektimit. Mjetet dezinfektuesen fillimi ishin ndërsa më pas jo. Për kushtet teknike dhe ndjekja online nuk u bë asnjë tentim dhe mbeti e pa-përgjigjur pyetja se përse nga çdo sallë e kuvendit nuk mund të ketë kanal të posaçëm në Youtube për ndjekje të punës drejtpërdrejtë (çdo sallë është e pajisur me kamera dhe regji, pra duhet vetëm internet) kur ajo është pa pagesë”.*

Gazetarja Neshkova vlerëson se Kuvendi në të ardhmen duhet të angazhojë *“persona për marrëdhënie me publikun dhe të mos kursehet në transparencë. Pandemia të mos shfrytëzohet si arsye të caktohen seanca në salla ku nuk ka qasje për ndjekje të drejtpërdrejtë që të përjashtohet opinioni”.*



Sonja Delevska, gazetare ne online mediumin **SDK.mk**, për funksionimin e kuvendit dhe transparencën në periudhën e pandemisë thotë se ka pasur “Organizim të keq dhe ngurrim që të lehtësohet puna e gazetarëve, posaçërisht kur bëhet fjalë për informacion të shpejtë për materiale të pranuar, ligje, propozim ligje, ndryshim të ligjeve, numra të amendamenteve, përmbajtje të amendamenteve, iniciatorët. Është e tepruar dhe maltretim për gazetarët takimet protokollare të kryetarit të Kuvendit, nënkryetarëve, grupeve parlamentare, për të cilat gazetarët nuk janë të interesuar, ardhja në konferenca, por jo për tema për të cilat pyesin gazetarët dhe jo nga deputetët në

të cilët ata insistojnë, por për tema tjerë ose për përplasje partiake për të cilat ata vlerësojnë se janë të rëndësishëm për opinionin”.

Për çështjen e transparencës dhe llogaridhënies gazetarja Deleska vlerëson se “transparenca dhe llogaridhënia e kësaj përbërje parlamentare është në pikën më të ulët deri tani. Posaçërisht do të mbahet mend periudha nën kupolën në Kuvend, kur opinioni nuk kishte pikë kontakti me deputetët, deri në shkallë që të mos jemi të sigurt se me të vërtetë ka seanca të kuvendit dhe nëse në të vërtetë janë deputetët në punë ose më parë kanë iniciuar film të metrazhit të gjatë, dhe kanë emetuar reprizë në kanalin e kuvendit. Nuk kishte se si të shkruhet dhe të hulumtohet temë nga shtëpia ligjvënëse, komunikimet ishin në Viber nëpërmjet njohjeve personale me deputetët, shpesh pa sukses që të sigurohet pala tjetër në tregimin”.

Në lidhje me problemet për kontakt me deputetët por edhe transparencën, ajo vlerëson se “Komunikimi është problemi më i madh dhe më i rrezikshëm. Nëse arrijmë të flasim me ta, potencojë në Viber ose në Whatsapp, assesi në linje të rregullt, dhe shkruani tekst, më pas ju paraqitet dhe ju thotë: “nuk kam thënë ashtu korrigjoje. Kontakt fizik nuk kam pasur me asnjë deputetë”. Në pyetjen nëse është ballafaquar me presion për tekst të shkruar, gazetarja Sonja Delevska përgjigjet se: Përpos kërkesës për korrigjim të deklaratave të tyre që mi kanë dhënë deputetët, varësisht nga ajo se sa i kanë qortuar në parti, kërkesa tjera nuk ka pasur e as demante”.

Ndërsa për kushtet teknike dhe tentimet që ato të përmirësohen vlerëson se “Kuvendi jo vetëm që nuk ka kushtet teknike për ndjekje normale të punës, por edhe ka një faqe të

ngadaltë dhe të vjetruar, të pa-përditësuar në kohë dhe internet shfletues të vjetërsuar (Internet Explorer) për ndjekjen e seancave i cili në kompjuterët e ri as që mund të instalo-het. Nëse cilësohet si e pasuksesshme lutja e spikerit Talat Xhaferi të ndryshohet Rreg-ullorja dhe të vendoset puna online e Kuvendit e cila do të jetë e qasshme dhe hapur për tërë opinionin, tentim tjetër nuk ka pasur. Pikë e ndritshme është vetëm shefja e kabinetit të kryetarit Talat Xhaferi, e cila zakonisht është e kapshme për gazetarët, kur nuk është në pushim vjetor, por ajo është përgjegjëse vetëm për informacionet e Xhaferit dhe nuk mund të vrapojë dhe t'i detyrojë deputetët të japin informacione dhe të na përgjigjen në pyetje dhe dilema".

Për të ardhmen, gazetarja Sonja Delevska rekomandon dhe sugjeron se "duhet shërbimi për marrëdhënie me opinionin në bashkëpunim me të gjithë shërbimet kuvendore para së gjithash, edhe me deputetët dhe me presidentin, të jenë në kontakt tërë kohën për nevojat e opinionit (gazetarëve). Është e palejueshme në shekullin 21 të presim me ditë dhe javë për një informacion nga Kuvendi dhe në fund të mos e marrim në 90 për qind të rasteve. Kuvendi momentalisht është institucion më dembel dhe më jotransparent në Maqedon-inë e Veriut. Deputetët nuk duhet t'i injorjnë shërbimet e kuvendit kur gazetari kërkon informacion, incizim, ose kronikë. Në emër të transparencës, funksioni më i lartë në shtet, i deputetit, duhet të jep shembull se si vihet në dispozicion të gazetarëve dhe të opinionit, të paktën gjatë kohës së punës dhe me urgjencë të vendoset sistem i informimit me trans-parencë për çdo pyetje. Galeria në Sallën 1 është e vogël, ballkonet e premtuara shtesë nuk u ndërtuan. Një nga lëshimet bazike është se nuk ka mikrofon që të dëgjohen pyetjet e parashtruara të gazetarëve dhe kështu qytetarët, publiku i dëgjojnë vetëm përgjigjet e deputetëve, të cilët duke e ditur këtë shpesh manipulojnë dhe flasin për diçka të tretë, në vend që të përgjigjen në mënyrë direkte në pyetjen".

QËNDRIMI DHE MENDIMI I DEPUTETËVE

Përfaqësuesit e Kuvendit u përgjigjën në këto pyetje konkrete:

1. Si do ta kishit vlerësuar funksionimin e kuvendit në kushte të kovid-19 në aspekt të transparencës dhe llogaridhënies, krahas nevojës për respektim të protokolleve shëndetësore?
2. Sa shpesh komunikoni me gazetarët të cilët e ndjekin punën e Kuvendit, a përgjigjen rregullisht në thirrjet e gazetarëve dhe pyetjet e parashtruara?
3. Nëse gjatë publikimit të informacioneve ose prezantimeve të qëndrimeve grupi i juaj i deputetëve preferon gazetar të cituar ose mediume?
4. A keni patur në vitet e kaluara konflikt me gazetar dhe a jeni ballafaquar me situatën kur keni vlerësuar se një deklaratë e juaja ose e grupit parlamentar është transmetuar në mënyrë jo të duhur?
5. Çfarë sipas jush, mund të ndërmerret që të mundësohet transparencë më e madhe në shtëpinë ligjvënëse dhe komunikim më të lehtë në mes anëtareve të kuvendit, administratës dhe gazetarëve?



Nënkryetari i Kuvendit, Goran Misovski vlerëson se “edhe në kushte të kovidit Kuvendi ka qenë maksimalisht transparent në punën. I ka respektuar të gjitha protokollet shëndetësore dhe ka bërë përpjekje maksimale që puna e deputetëve të jetë e kapshme për mediat, punëtorët mediatik dhe qytetarët”.

Në pyetjen për kontaktet me gazetarët, Misovski shpjegon “për shkak se jam më tepër mandate deputet, një nga prioritetet e mia ishte dhe mbetet të jem në dispozicion për mediat dhe komunikimi i vazhdueshëm me përfaqësuesit e medimeve. Komunikimi pothuajse për çdo ditë është në bazë ditore, me qëllim të

informimit më të mirë për punën e deputetëve.” Ai thotë “çdoherë kam qenë i kapshëm për të gjitha mediumet dhe për të gjithë përfaqësuesit mediatik” ndërsa për konflikte eventuale me gazetarët shtonë se “Asnjëherë nuk kam pasur konflikt me cilin do medium ose përfaqësues dhe vlerësoj se deri tani të gjithë i kanë transmetuar në mënyrë korrekte qendrimet e mia.”

Për nevojën për transparencë në të ardhmen nënkryetari i Kuvendit, Goran Misovski thotë se “komunikimi me mediumet është në nivel profesional. Transparenca e institucionit, megjithatë, është perceptcion dhe mund të jetë e interpretuar në mënyrë të ndryshme edhe nga qytetarët edhe nga mediumet dhe përfaqësuesit e tyre. Në kontekst të kësaj është edhe hulumtimi i fundit i mendimit publik, sipas të cili 51 për qind e të anketuarve thonë se pjesërisht ose tërësisht janë të njoftuar me aktivitetet në shtëpinë ligjvënëse në periudhën e kaluar, ndërsa 48 për qind kanë thënë se pak ose fare nuk janë të njoftuar me performancat e deputetëve”.



Koordinatori i grupi parlamentar të LSDM-së, Jovan Mitrevski, në pyetjen për vlerësimin e funksionimit të kuvendit në kushtet të pandemisë covid-19, nga aspekti i transparencës dhe llogaridhënies u përgjigj se “Kovid-19 nga aspekti i protokolleve shëndetësore, si dhe çdo kund, ashtu edhe tek ne ka shkaktuar pengesa të caktuara në funksionimin. Megjithatë, fal shërbimeve të kuvendit dhe menaxhmentit të kuvendit mendoj se u sigurova mënyrë adekuate të funksionimit, me çka opinioni nëpërmjet mediumeve me kohë ishte i informuar për atë se çfarë po ndodhë në Kuvend dhe ajo që është punë dhe obligim dhe detyrë e deputetëve. Vlerësoj se edhe në kushtet të tilla të funksionimit

transparenca dhe llogaridhënia ishte ruajtur. Për atë rol të madh kanë edhe raportuesit e kuvendit, gazetarët, të cilët ndihmuan që informacionet të arrijnë me kohë deri tek qytetarët”.

Në pyetjen sa shpesh komunikon me gazetarët, Ai përgjigjet se “komunikimi me gazetarët është në bazë ditore, shpesh edhe në nivele të orëve, gjatë ditëve kur ka më tepër dinamikë në punën dhe kur hapen tema të ndryshme që janë në interes të qytetarëve. Në grup

të madh parlamentar siç është e jona, çdoherë ka deputetët i cili komunikon me gazetarët për temë e cila është në interes të gazetarit. Nuk ekziston çështjet që është parashtruar deri te grupi jonë parlamentare ose tek deputetët i caktuar dhe e njëjta të mos jetë përgjigjur. Jam i bindur se kjo do të vazhdojë edhe në të ardhmen".

Për atë nëse preferon gazetarë dhe media të caktuara kur do t'i kumtojë qëndrimet e grupit parlamentar të cilin e udhëheq, Mitrevski thotë "Jo. Shpërndarja e informacioneve është më shpesh nëpërmjet pres-konferencave të caktuara ndërsa nëpërmjet shërbimeve të kuvendit deri tek të gjitha mediumet. Në mënyrë shtesë jashtë konferencave për shtyp, kur ka çështje të parashtruar nga gazetarët, përgjigjemi ashtu siç i marrim pa asnjë preferencë."

Në pyetjen nëse ka konflikt me gazetarët, Mitrevski përgjigjet "ka pasur situata të parëndësishme kur ndonjë informacion nuk është transmetuar në mënyrë precize, me çka i është dhënë kuptim ndryshe të qëndrimit të grupit parlamentar. Situatat e tilla i kemi zgjidhur me shpjegime shtesë me çka informacioni është precizuar. Asnjëherë nuk ka ndodhur konflikt mes deputetit nga grupi i jonë parlamentar dhe gazetarë. Kërkesa jonë e vetme deri tek gazetarët është dhe do të jetë informacionet, deklaratat, fjalimet nga grupet punuese dhe seanca plenare të transmetohen në mënyrë të balancuar nga të gjitha grupet parlamentare, me çka qytetarët do të mund qartë të shohin qëndrimet për çështje të caktuara dhe në këtë mënyrë që gjykojnë për punën e grupit të caktuar apo deputetit".

Në lidhje me atë se çfarë duhet të ndërmerret nga ana e Kuvendit që të mundësohet transparencë me madhe në shtëpinë ligjvënëse, koordinatori i grupit parlamentar të LSDM-së thotë: "Reforma në kanalin e kuvendit e cila po ndodh do të sjellë komunikimi më të lehtë, por çdoherë mund më shumë dhe më mirë të lehtësohet komunikimi duke ndjekur zhvillimin e teknikës informative dhe teknologjisë. Kjo është diçka që pres se do të ndodhë në periudhën e ardhshme për shkak se menaxhmenti i kuvendit është fuqishëm i koncentruar në këtë çështje duke punuar në shumë projekte me organizata të cilat japin përkrahje përpos eksperte por edhe financiare për zbatimin e tyre".



Koordinatori i grupit parlamentar të VMRO-DPMNE-së, Nikolla Micevski, për transparencën dhe llogaridhënien e Kuvendit në periudhën e pandemisë me KOVID-19, mendon se *“transparenca ka mundur të jetë në një nivel pak më të lartë, posaçërisht në pjesën e ndjekjes fizike të seancave dhe komisioneve nga ana e gazetarëve, ndërsa kjo u ishte pamundësuar gazetarëve”*.

Për atë se sa shpesh komunikon me gazetarët, Micevski shton se *“Kam komunikim të rregullt dhe korrekt me gazetarët në Kuvend dhe shumë shpesh, pothuajse çdoherë u përgjigjem thirrjeve telefonike”*. Ai shton

se nuk bën dallim dhe nuk i ndanë gazetarët, por *“të gjithë njësoj janë trajtuar”*.

Për përvojë eventuale për konflikt me gazetarët ose interpretim të papërshtatshme të deklaratës, koordinatori i grupit parlamentar të VMRO-DPMNE-së, thotë se po, ka pasur përvojë të tillë *“në dy tre raste ka pasur transmetim jo korrekt / jo të saktë të qëndrimit tim, ndërsa pas reagimit tim kishte ndërhyrje në titullin / lajmin por nuk jam i sigurt nëse lajmi rastësisht është interpretuar gabimisht”*.

Në pyetjen se çfarë duhet të ndërmerr Kuvendi për transparencë më të madhe, Micevski thotë: *“Ndryshimi i ueb faqes me transmetim të drejtpërdrejtë të më shumë komisioneve, mbulim më të madh të seancave me gazetarë, lejim për prezencë të gazetarëve në studion e kuvendit. Përfundimi i rikonstruimit dhe modernizim i studios së re të kuvendit. Poashtu, mendimi im është se punën e kuvendit duhet ta ndjekin gazetarë të specializuar me përvojë më të madhe dhe njohuri për procedurat e funksionimit të kuvendit. Sipas meje, hyrja në kuvend dhe raportimi pa njohje të procedurave nga gazetarë nuk e jep efektin e duhur”*.



Arbër Ademi, koordinatori i grupit parlamentar të BDI-së, vlerëson se “edhe përkundër kufizimeve të cilat i ka imponuar pandemia me Kovid-19 dhe obligimet për mbrojtje të shëndetit personal dhe publik, vlerësimi im është se Kuvendi mbeti transparentë në punën e tij dhe në llogaridhënien. Shërbimet kompetente të Kuvendit në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për mbrojtje të shëndetit publik kanë përgatitur protokolle me të cilat ju mundësua deputetëve të njoftojnë opinionin për aktivitetet e tyre, është pajisur salla e pres-konferencave, me respektimin e të gjitha protokolleve nga Kovid-19 edhe të deputetëve, punëtorëve të shërbimit dhe të gazetarëve. Siç ishte i

informuar opinionin Kuvendi mbledhë në ‘sallën e kupolave’, përsëri për shkak të respektimit të të gjitha protokolleve për mbrojtje të shëndetit, ndërsa pas përmbylljes së suksesshme të procesit të imunizimit së pari të shërbimeve, dhe më pas edhe të deputetëve, u mundësua që Kuvendit të vazhdojë me punë në sallën plenare. Nuk duhet të harrojmë se si deputetë kemi obligim dhe detyrim që të jemi në komunikim të vazhdueshëm me qytetarët, ndërsa ky proces është posaçërisht i lehtësuar me përdorimin aktiv të rrjeteve sociale që mundëson transmetim të mesazhit dhe lajmin e saktë deri tek qytetarët dhe opinionin”.

Në pyetjen për komunikimin me gazetarët, përgjigjet se “Komunikimi me gazetarët është në bazë ditore. Personalisht çdoherë përgjigjem thirrjeve edhe në mesazhe elektronike nga cilido gazetarë që më është drejtuar”.

Për atë nëse preferon një gazetar të caktuar ose medium për shpërndarjen e informacioneve ose qëndrimeve partiake, Ademi përgjigjet “në karrierën time çdoherë jam udhëhequr nga parimi i profesionalizmit, paanshmërisë, transparencës dhe përgjegjësisë, edhe ndaj lajmit të shpërndarë edhe ndaj deklaratës dhe transmetimit të të njëjtës. Që këtu, nuk anojë ndaj një mediumi të caktuar ose gazetarit në punën time të përditshme, përkundrazi i respektoj të gjithë përfaqësuesit e mediumeve, qofshin ato gazetarë, kameramanë apo fotoreporterë”.

Për konflikte eventuale dhe mospajtueshmëri me gazetarët, shefi i grupit parlamentar të BDI-së thotë “Nuk më kujtohet ndonjë situatë e tillë. Vlerësoj se çdo informacion që është siguruar jepet me saktësi dhe ashtu siç duhet. Gazetarët e akredituar në Kuvend janë

prezentë në konferencat për shtyp të grupit tim parlamentar dhe që këtu i transmetojnë informacionet drejtpërdrejtë.”

Për atë se çfarë mund të ndërmerret që të mundësohet transparencë më e madhe në shtëpinë ligjvënëse, Ademi thotë: *Personalisht vlerësoj se komunikimi mes Kuvendit dhe përfaqësuesve të mediumeve është transparent dhe në nivel të lartë. Një pjesë e madhe e gazetarëve dhe administratorëve shumë shpesh personalisht u drejtohen jashtë protokolleve të vendosura zyrtarisht për thirrje të konferencave për media. Ndoshta më adekuate është që të bëhen plotësime në internet faqen e Kuvendit dhe çdo deputetë të ketë lidhje me faqen ku në mënyrë të detajuar do të paraqet punën e tij dhe aktivitetet. Sigurisht, do të apelojë tek kolegët që sa më shumë t'i shfrytëzojnë rrjetet sociale, posaçërisht në këtë kohë, ku burimi kryesor për lajmet dhe risitë, posaçërisht për të rinjtë, vijnë nga rrjetet sociale.*



Skender Rexhepi, Koordinator i grupit parlamentar i Aleancës së Shqiptarëve dhe Alternativës, për transparencën e funksionimit të Kuvendit në kushte të pandemisë vlerëson se *“në përgjithësi Kuvendi është përkujdesur që të respektohen masat parandaluese lidhur me virusin Covid-19. Por, shpesh këto masa janë keqpërdorur për qëllime politike në interes të shumicës në Kuvend, posaçërisht në dëm të informimit transparent dhe vendimeve politike dhe ky fakt do të mbetet njollë e zezë në punën e Kuvendit”.*

Për komunikimet me gazetarët të cilët e ndjekin punën e Kuvendit, Rexhepi thotë se *“komunikimi me gazetarët e akredituar në Kuvend, është në nivelin e duhur profesional dhe demokratik. Sa më përket mua, nuk ka pasur thirrje në të cilën nuk jam përgjigjur”.*

Gjatë publikimit të informacioneve dhe prezantimit të qëndrimeve të grupit parlamentar të ASH-AAA, vlerëson se *“nuk ka dallim mes gazetarëve, me përjashtime për ata gazetarë që përhapin dezinformata me qëllim ose paqëllim”.* Për atë nëse në vitin e kaluar ka pasur konflikt me gazetarë dhe a është ballafaquar me situatë ku ka vlerësuar se në mënyrë

joadekuate është transmetuar deklaratë e tij ose informacion, thotë se jo. Por shton se “ka pasur raste të informimit të keq”. Për atë se çfarë mund të ndërmerret në të ardhmen për transparencë më të madhe nga ana e Kuvendit, Rexhepi sygjeron “që të sigurohen kushte të barabarta profesionale për pjesëmarrje të barabartë për të gjithë mediumet në Kuvend, me çka lëshimet eventuale në fushën e transparencës do të zbresin në minimum”.



Deputeti Kastriot Rexhepi nga radhët e Lëvizjes Besa, për transparencën në Kuvendin mendon se “edhe në kushte të Kovid protokolleve, kuvendi është transparent nëpërmjet transmetimit të seancave në kanalin e kuvendit dhe ka qasje të lehtë për mediat për t’i marrë këto materiale. Gjithashtu, në ueb faqen janë të publikuara aktivitetet e planifikuara dhe vendimet që janë marrë”.

Për atë se sa shpesh ka pasur komunikim me gazetarët, deputeti Kastriot Rexhepi, informon se “Sa i përket komunikimit me mediumet, ata çdoherë janë të gatshëm që të përgjigjen për kërkesat ose pyetjet. Për fat të keq, kërkesat e mediumeve nuk janë të shpeshta ngase janë të fokusuar në përfaqësuesit e partive ose koalicioneve si LSDM, VMRO-DPMNE, BDI, Aleanca dhe E Majta. Edhe pse ne japim qëndrime dhe kemi deklarata, të njëjtat nuk janë transmetuar, dhe që këtu, rrjetet sociale mbeten si mjeti kryesor për transmetimin e atyre qëndrimeve”.

Në pyetjen nëse kanë gazetarë të preferuar ose mediume për shpërndarjen e informacioneve, deputeti i Lëvizjes Besa thotë “nuk kemi mediume të preferuara, për shkak se edhe ashtu nuk kemi shumë hapësirë për të zgjedhur. Gjithashtu, me kërkesë të opozitës nga partitë shqiptare, nuk kemi ftesa për emisione debative për shkak se në të kundërtën ata nuk do të marrin pjesë në të njëjtat. Me këtë jemi të dëmtuar, pa hapësirë për ta shprehur qëndrimin tonë dhe me këtë edhe të debatojmë. Me këtë shkelet edhe përfaqësimi i drejtë në hapësirën mediale të deputetëve të Lëvizjes Besa”.

Për atë nëse ka konflikt ose paqartësi me gazetarë, deputeti Kastriot Rexhepi thotë se “duke u udhëhequr nga rregulli se nuk duhet të futet në konflikt me gazetarët, ne edhe nuk futemi në konflikte, edhe pse ka pasur transmetim tendencioz të qëndrimeve tona, me shtrembërime ose vendosje të titullin që nuk korrespondon me tekstin e lajmit. Duke

e pasur parasysh se lexuesit më tepër i lexojnë vetëm titujt, me atë na shkaktohet dëm. Për një rast kemi reaguar dhe i njëjti ishte korrigjuar, por më ishte marrë nga medime tjera. Kishte rast kur në një televizion nacional një deklaratë e imja në lajme qendrore ishte prezantuar me emër dhe mbiemër të një deputeti tjetër dhe partie tjetër, ndërsa për këtë kemi kontaktuar redaktorin përgjegjës”.

Sa i përket asaj se çfarë duhet të ndërmerret që të përmirësohet transparenca e Kuvendit, deputeti Rexhepi vlerëson se “ajo është një rrugë dykahëshe. Kuvendi mundëson prezencë të gazetarëve nëpërmjet akreditimeve, por edhe gazetarët duhet të kenë kontakt, t'u japin mundësi të gjithë deputetëve nga grupet parlamentare, por edhe atyre që nuk janë të organizuar në grupet parlamentare, ngase edhe ata kanë mandat dhe janë përfaqësues të popullit. Duhet qëndrimet dhe fjalimet të transmetohen qoftë edhe me përqindje me kohë. Në të kundërtën të njëjtit do të jenë të heshtur dhe të destimuluar që të jenë aktiv edhe më shumë”.

9

BISEDË ME KRYETARIN E KUVENDIT TË MAQEDONISË SË VERIUT, TALAT XHAFERI



Në bisedë me Kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, në temën “Transparenca e Kuvendit gjatë periudhës së pandeminë me kovidin”, Ai shpjegoi se edhe pse si çdo kund, pandemia ka ndikuar në funksionimin e Kuvendit të Maqedonisë, posaçërisht në pjesën e prezencës fizike të deputetëve në mediat. Por, ai shtoi se “tani po bëhen përpjekje që të tejkalohen dobësitë të cilët janë vërejtur, kështu që janë duke rrjedhur disa furnizime publike”.

Ai thotë se janë duke rrjedhur disa furnizime publike për sigurimin e kushteve teknike për transparenca më të madhe të Kuvendit me atë që disa salla duhet të

pajisen me pajisjet e nevojshme që gazetarët por edhe opinioni të mund të ndjekin drejt-përdrejtë me livestream seancat e komisionit.

“Siç ishte paralajmëruar në brifingjet e shumta më parë, është paralajmëruar furnizim publik për rindërtim të faqes e-kuvendi, ajo procedurë është mbyllur. Në mënyrë shtesë do të duhet për sallat, kjo është një furnizim tjetër i posaçëm që të mund në mënyrë teknike të ndiqet puna dhe në fazën përfundimtare, para nënshkrimit të marrëveshjes jemi me furnizimin e sallës penale me sistem të ri elektronik, që të kenë qasje jo vetëm ekipet e gazetarëve të cilët janë në Kuvend por edhe më gjerë, qytetarët të mund të kyçen dhe ta ndjekin punën e kuvendit nëpërmjet internetit”, ka thënë Xhaferi. Kryetari i Kuvendit, shpjegon se rindërtimi i ueb faqes dhe e-kuvendit, gazetarëve dhe qytetarëve do t'u mundëson që të gjejnë të gjitha seancat dhe gjitha fjalimet e deputetëve në seancat plenare por edhe në seancat e komisionit, edhe atë në kohë reale.

Xhaferi mendon se transparenca e Kuvendit është përmirësuar për dallim nga përbërjet e tjera të Kuvendit, por shton se çdoherë duhet të punohet në përmirësimin e transparencës. Për këtë shkak, informon se në buxhetin e Kuvendit duhet të parashikohen mjete shtesë. Në prizmin e transparencës më të madhe informon se Kuvendi planifikon vendosjen e TV Studios në Kuvend, ku do të mund të zhvillohen debatet mes deputetëve dhe e cila do të funksiononte nëpërmjet kanalit të Kuvendi në TVM-së.

Xhaferi thotë se në përgjithësi është i kënaqur nga transparenca e Kuvendit në katër vitet e kaluara, pasi që ai është në krye të pushtetit ekzekutiv. *“Nuk ka çështje për të cilën nuk është përgjigjur me kohë, ndërsa e cila është dorëzuar në përputhje me Ligjin për qasje deri te informacionet me interes publik, në mandatin tim është vendosur praktika e brifingjeve të rregullta mujore me përfaqësues të medimeve, që duhet të paraqet motiv shtesë për të gjithë grupet parlamentare, për komunikim të rregullt me gazetarët. Gjithashtu, para Kuvendit janë vendosur tabela informative në të cilat publikohen informacionet për punën e Kuvendit që të mund qytetarët në çdo moment të informohen për ngjarjet në Kuvend, dhe për atë se çfarë diskutohet për momentin në Kuvendin”, thotë Xhaferi.*

Ai thekson se në përgjithësi nuk ka pasur probleme më të mëdha me mediumet. *“Ka pasur lajme jo precize dhe jo të sakta dhe aty ku është dashur kemi demantuar. Por nuk jam ithtarë i asaj që të favorizohen ose të injorohen medime të caktuara. Unë nuk kam refuzuar asnjë medium. Por nuk duhet edhe mediumet të kenë politikanë të favorizuar dhe jo të favorizuar”, thekson Xhaferi.*

KONKLUSIONE

- ◆ Kriza e kovidit i theksoi në mënyrë shtesë dobësitë në funksionimin e shtëpisë ligjvënëse në pjesën e transparencës, llogaridhënies dhe komunikimit me mjetet e informimit, të cilat më parë u fshinin nën petkun e kushtetutës dhe normativat e rregullores për punë për qasshmëri dhe publicitet në punën e kuvendit.
- ◆ Përbërja e dhjetë parlamentare e filloi mandatin në kushte të kufizuara, të cilat u treguan si faktor kufizues edhe për komunikimin me mediumet, posaçërisht për deputetët të cilët këtë e kanë mandatin e parë.
- ◆ Restriksionet në parlament, të imponuara nga kovid-protokollet, paraqisnin faktor kufizues edhe për gazetarët, të cilët në numër të madh të rasteve shumë më vështirë nga e zakonshmeja arrinin deri tek informacionet gjithëpërfshirëse dhe deri tek pozicionet e të gjithë faktorëve relevantë për temë të caktuar, me çka publikut i shkurtohet mundësia që të shoh, dëgjojë ose lexojë të gjitha aspektet për problem të caktuar e që është me interes publik.
- ◆ Si një nga hallkat më të dobëta u imponua funksionimi i komisioneve, transparenca e të cilave ishte shndërruar në minimum, për shkak se, për dallim nga seancat plenare, nuk u siguruan kushtet teknike për transmetime të drejtpërdrejta nga debatet e komisioneve.
- ◆ Brifingjet e rregullta mujore të Kryetarit të kuvendit janë rrethana lehtësuese për raportuesit e kuvendit, ndërsa posaçërisht kanë ndihmuar gjatë kulmit të pandemisë, por nuk mund ta kompenzojnë komunikimin e kufizuar me përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare, pozicionet e të cilëve jo shpesh janë në përplasje për më shumë tema me interes të lartë publik, ndërsa shpesh janë të ndryshëm nga pozicionet e opsionit politik përfaqësues i të cilit është parlamenti i parë.
- ◆ Ueb faqja e Kuvendit nuk i jep në kohë reale dhe më të shpejtë videot nga seancat e Kuvendit por edhe të Komisioneve. Nuk mundëson që të shkarkohen (incizohen) në kohë reale video materialet. Nuk ngjiten shpejtë të gjithë propozim ligjet, dhe të gjitha materialet tjera që janë të rëndësishme për gazetarët.

- ◆ Kuvendi nuk ka kanale të veta në rrjetet sociale ku mund në mënyrë të drejtpërdrejtë të transmetohen të gjitha seancat e komisioneve. Ende shfrytëzohen aplikacione të vjetruara, të cilat janë pothuajse jashtë përdorimit, që të mund të ndiqen live seancat e Kuvendit.

REKOMANDIME

- ✓ Është e nevojshme të analizohen të gjitha mundësitë për hapjen e komisioneve për opinionin, para se gjithash me prezencë fizike të gazetarëve, ndërsa për këtë mund të shqyrtohet opsioni për vërtetimin preciz të renditjes së seancave të komisionit, që të mundet çdo komisionit t'i sigurohet të mbahet në sallë ku mund të mbahet distanca mes atyre që janë prezentë. Kur nuk do të jetë e mundur, duhet të gjendet mënyrë të sigurohen kushtet teknike për transmetim të drejtpërdrejtë të diskutimeve në kuvend nëpërmjet kanalit të Kuvendit ose livestream.
- ✓ Të mendohet të mbahen trajnime të posaçme për deputetët për marrëdhënie me opinionin, që të mund të organizohen debate interne mes deputetëve dhe gazetarëve, posaçërisht në fillim të mandatit të përbërjes së re edhe për deputetët për të cilët kjo është mandati i parë.
- ✓ Të shqyrtohet mundësia për vendosjen e praktikës për brifingje periodike / të rregullta të koordinatorëve të grupeve parlamentare me gazetarët dhe çdo grup parlamentar të caktojë person për kontakt me gazetarët.
- ✓ Do të ishte e dëshirueshme që në kudër të procesit "Zhan Mone", debati i të cilit është duke rrjedhe dhe tema kryesore e të cilit janë ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit, të hapet debat për ndryshimet e mundshme të cilët do të kishin kontribuar në më tepër transparencë dhe llogaridhënie të Kuvendit, kështu që në këtë aspekt në dialogu do të ishin kyçur edhe gazetarë që e ndjekin punën e Kuvendit.
- ✓ Është e nevojshme një ueb faqe më cilësore e Kuvendit, në të cilën më shpejtë dhe më lehtë do të mund të sigurohen video materiale nga seancat plenare të Kuvendit dhe nga seancat e komisioneve. Ueb faqja duhet të jetë më efikase dhe të azhurnohet në kohë më të shpejtë në mënyrë që të ngjiten në atë ueb faqe propozim ligjet dhe dokumente

tjera publike të nevojshme për gazetarët që të mund në mënyrë precize dhe në detaje të raportojnë për publikun.



Kuvendi të hap kanale të reja në rrjetet sociale, si për shembull në platformën 'Youtube' ku do të transmetohen nëpërmjet strimingut të gjitha seancat e komisioneve. Ose, seancat të transmetohen drejtpërdrejt në 'Facebook' ose aplikacione të ngjashme. Në këto aplikacione duhet të ekzistojë mundësia për të shkarkuar video materialet nga seancat dhe konferencat për shtyp dhe të shfrytëzohen nga ana e mediave.

BURIMET E SHFRYTËZUARA

- ◆ Intervista me koordinatorët e grupeve parlamentare në Kuvend dhe me deputetë me pyetje të parashtruara paraprakisht;
- ◆ Intervistë me kryetarin e kuvendit Talat Xhaferi;
- ◆ Intervista me gazetarë me pyetje të parashtruara paraprakisht;
- ◆ Kushtetuta e RMV-së;
- ◆ Rregullorja e Kuvendit të RMV-së;
- ◆ Kodeksi Etik i Kuvendit të RMV-së;
- ◆ Anketë për perceptimet për funksionimin e Kuvendit të RMV-së;

Ky publikim është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyrojnë pikëpamjet zyrtare të cilës do palë.

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t'i ndajë arritet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të saj.

www.europa.eu

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

